



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

OPINION

I AVOKATIT TË POPULLIT

lidhur me

*Ilogaritjen e pushimit vjetor në bazë të përvojës së punës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për
Zyrtarët Publikë*

A.nr 505/2021

A.nr 712/2021

Për:

Z. Xhelal Sveçla, ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Hekuran Murati, ministër
Ministria e Financave, Punës dhe Tranfereve

Z. Jeton Koca, kryetar
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Znj. Hajrije Morina, drejtoreshë
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Prishtinë, më 14 prill 2022

Qëllimi

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, përkatësisht i të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, në lidhje me llogaritjen e pushimit vjetor në bazë të përvojës së punës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Zyrtarët Publikë).

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesë nga z. Behxhet Bala dhe nga disa ankues të tjerë, nëpunës civilë në Autoritetin Rregullator të Shërbimeve të Ujit (në tekstin e mëtejshëm: ARrU), përkitazi me mosllogaritjen e ditëve të pushimit vjetor në bazë të përvojës së punës, të fituara me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Shërbimin Civil).

Ankuesi ka njoftuar se pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, llogaritja e pushimit vjetor për nëpunësit civilë po bëhet në atë mënyrë që atyre po u humbin ditët e pushimit vjetor të fituara me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për arsye të njëjta, Avokati i Popullit ka pranuar ankesë të ngjashme nga z. Musa Islami, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Çështjet kontestuese

Avokati i Popullit vëren se çështje kontestuese është llogaritja e pushimit vjetor sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë, duke mos e llogaritur pushimin e fituar sipas Ligjit për Shërbimin Civil. Përmes kësaj llogaritjeje, nëpunësve civilë po u humb e drejta e cila është fituar me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit ka vërejtur se llogaritja e pushimit vjetor deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë është bërë sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil.

Sipas Ligjit për Shërbimin Civil, neni 39 [Pushimi vjetor], paragrafët 2 dhe 3, përcakton:

“2. Gjatë çdo viti kalendarik, nëpunësi civil ka të drejtë në pushim vjetor me pagesë me kohëzgjatje minimale prej tetëmbëdhjetë (18) ditë pune, në shkallën prej një ditë e gjysmë (1.5) për çdo muaj kalendarik të punësimit.

3. Kohëzgjatja e pushimit vjetor do të përcaktohet në bazë të përvojës së punës dhe me këtë rast çdo dy (2) vjet përvojë pune e rrisin pushimin vjetor për një (1) ditë pune.”

Ndërsa Ligji për Zyrtarët Publikë, neni 18 [E drejta për kushte të përshtatshme të punës], paragrafi 4, përcakton se :

“4. Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës”.

Ligji nr. 03/L-212 e Punës (në tekstin e mëtejshëm Ligji i Punës), neni 32 [Pushimi vjetor], paragrafët 1 dhe 2 përcaktojnë:

“1. I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar.

2. Zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një ditë pune.”

Ligji për Shërbimin Civil ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2010 dhe se nga ajo kohë nëpunësit civil kanë fituar të drejtën e llogaritjes së pushimit vjetor sipas nenit 39 të këtij ligji.

Ligji për Zyrtarët Publikë ka hyrë në fuqi në korrik 2020, prandaj llogaritja e pushimit vjetor duhet të bëhet nga muaji korrik 2020 e në vazhdim, duke mos e cenuar të drejtën (pushimin vjetor në bazë të përvojës së punës) e cila është fituar gjatë periudhës së zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil.

Avokati i Popullit thekson se e drejta e fituar me Ligjin për Shërbimin Civil nuk mund të humbë me Ligjin për Zyrtarët Publikë, sepse kjo përbën zbatim prapaveprues të ligjit, gjë që ndalohet, përveç nëse shprehimisht parashihet me ligj. Zbatimi prapaveprues i ligjit cenon pritshmërinë e ligjshme të nëpunësve civilë e po ashtu edhe sigurinë juridike.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive.

Koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GjEDNj-së (*shih rastet Kopecky v. Slovakia, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, § 45-52; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794/98, § 73, GjEDNj 2002-VII*), “pritshmëria legjitime” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime e nëpunësve civilë për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës bazohet në të drejtën e fituar nga dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, gjatë periudhës sa ky ligj ka qenë në zbatim.

Avokati i Popullit konsideron se e drejta e fituar me Ligjin për Shërbimin Civil është e garantuar dhe se nëpunësit civilë kanë fituar të drejtën për pushimin vjetor sipas përvojës së punës gjatë periudhës kur Ligji për Shërbimin Civil ka qenë në zbatim. Mosllogaritja e pushimit vjetor të fituar me Ligjin për Shërbimin Civil e cenon sigurinë juridike të nëpunësve civilë dhe krijon një praktikë pasigurie që do t'i vendoste nëpunësit civilë dhe zyrtarët publikë në përgjithësi në pozitë pasigurie sa u përket të drejtave të cilat fitohen nga dispozitat e ligjeve në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit thekson se zbatuesit e ligjeve duhet të kenë kujdes që gjatë zbatimit dhe interpretimit të ligjeve të mos cenohen të drejtat e fituara me ligje të mëhershme. Pra, zbatuesit e ligjeve duhet të kenë gjithmonë parasysh sigurinë juridike të normës, nga e cila subjektet realizojnë të drejtat e tyre subjektive.

Avokati i Popullit konsideron se një normë e mëvonshme nuk mund t'ua mohojë subjekteve të drejtat që janë fituar nga një normë e mëhershme, rrjedhimisht një normë kurrsesi nuk mund të ketë veprim prapaveprues përveç rasteve specifike që parashihen me ligj dhe vetëm nëse një gjë e tillë është në të mirë të subjekteve.

Prandaj Avokati i Popullit konstaton se llogaritja e përvojës së punës sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë duhet të bëhet duke filluar nga periudha kur ky ligj ka hyrë në fuqi e në vazhdim, duke mos e cenuar numrin e ditëve të pushimit vjetor që janë fituar me Ligjin për Shërbimin Civil.

Avokati i Popullit thekson se nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrtarët Publikë duhet të kalojnë pesë vjet në mënyrë që nëpunësi civilë të fitojë një ditë pushimi vjetor (Ligji i Punës, neni 32, paragrafi 2), mirëpo numri i ditëve të pushimit vjetor në bazë të përvojës së punës, i fituar me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil (neni 39, paragrafi 3) mbetet i garantuar dhe nuk mund t'u mohohet nëpunësve civilë.


Përfundim

Avokati i Popullit thekson se pushimi vjetor është e drejtë e cila rrjedh nga marrëdhënia e punës. Për më tepër, Avokati i Popullit thekson se pushimi vjetor në bazë të përvojës së punës është e drejtë e cila u njihet nëpunësve civilë proporcionalisht me numrin e viteve të kaluara në punë sipas llogaritjes në dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil dhe të Ligjit për Zyrtarët Publikë, përkatësisht të Ligjit të Punës.

Avokati i Popullit konsideron se llogaritja e pushimit vjetor të fituar në bazë të përvojës së punës duhet të bëhet sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë, duke e llogaritur edhe pushimin vjetor në bazë të përvojës së punës të fituar gjatë periudhës sa ka qenë në zbatim Ligji për Shërbimin Civil.

Avokati i Popullit thekson se numri i ditëve të pushimit vjetor në bazë të përvojës së punës, të fituara me Ligjin për Shërbimin Civil, nuk mund të humbë, por duhet të llogariten si e drejtë e cila është fituar me një ligj paraprak.

Divizionet e burimeve njerëzore në institucionet e Republikës së Kosovës ku punojnë nëpunës civilë, ta llogarisin pushimin vjetor në bazë të përvojës së punës duke ia shtuar pushimit të fituar me Ligjin për Shërbimin Civil, ditët e pushimit që fillojnë të llogariten nga dita e hyrjes në fuqi e Ligjit për Zyrtarët Publik, sipas mënyrës së përcaktuar me këtë ligj.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit